

Ekonomia joformale në Shqipëri: A përbën ajo një pengesë për zhvillimin ekonomik? *

Jan-Peter Olters *
Përfaqësues i përhershëm i FMN-së

“Përmirësimi i administrimit fiskal konsiderohet i një rëndësie të veçantë nga qeveria, si për të kapërcyer sfidat për zhvillimin afatgjatë të vendit dhe për integrimin evropian, ashtu edhe për të siguruar burimet financiare që nevojiten për zbatimin e GPRS. Objektivi kryesor [...] i reformës së administrimit fiskal do të jetë ...të rriten të ardhurat buxhetore, duke zgjeruar bazën e taksueshme dhe duke pakësuar ekonominë joformale. ...”

Qeveria e Shqipërisë (2001, f. 59)

1. Hyrje

Procesi i bisedimeve me Bashkimin Evropian për një marrëveshje Stabilizim-Asocimi është një pasqyrim i qartë i progresit¹ që ka arritur deri tani Shqipëria gjatë tranzicionit të saj, ndonjëherë të vështirë. Për të avancuar këto bisedime, kërkohet përmbushje strikte e standardeve të caktuara për një vend evropian para-hyrjes² në Bashkimin Evropian, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Lidhur me këtë të fundit, politikë bërësit shqiptarë – pasi kanë kaluar etapën e stabilizimit pas krizës, - janë tashmë në gjendje të përqëndrojnë energjitë e tyre për sfidat më komplekse të zhvillimit ekonomik. Në përmbushje të integritimit politiko-ekonomik për në Evropë, me një strategji gjithëpërmblëdhëse për zhvillimin socio-ekonomik (SKZHES; GPRS e mëparshme)³, qeveria kërkon të kapërcejë trashëgiminë gjysmëshekullore të politikave të keqdrejtuara ekonomike, të cilat e kishin lënë vendin në varfëri të madhe, me një infrastrukturë publike të vjetruar, dhe me institucione publike të

* Komentë të mprehta nga Hossein Samiei, Jan Kees Martijn, Ivanna Vladkova-Hollar, Karen Ongly, David Hamoodi dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë në Konferencën e Katërt të Bankës së Shqipërisë me temë: “Ekonomia Shqiptare: Arritjet dhe Sfidat e Politikës Ekonomike”, mbajtur në Sarandë gjatë periudhës 11-12 shtator, e kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme këtë kumtesë dhe iu jemi shumë mirënjohës. Pikëpamjet e shprehura në këtë artikull janë pikëpamje të autorit dhe jo të FMN-së. Zbatohet standardi i heqjes dorë (nga një titull apo pretendim).

¹ Shihni, për shembull, IMF (2002, 2001a). Programi për stabilizimin ekonomik u kërkua për kapërcimin e krizës socio-ekonomike shkaktuar nga rënia shkatërruese e skemave në vitin 1997; shihni Bezemer (2001) and Jarvis (2000).

² Në datën 21 dhjetor 2002, Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian vendosi të ftojë Shqipërinë për fillimin e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit; shihni EU (2002a,b). Gjatë ceremonive të hapjes së negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, Presidenti i Komisionit Evropian, Romano Prodi, theksoi se Shqipëria —“një kandidat potencial” (Prodi 2003a)—po hidhte “hapat e pare drejt rrugës për t’u bërë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Evropian,” gjë që nënkupton se qeveria pranoi “një angazhim të madh” në shumë fusha, përfshirë “përmbushjen e një ekonomie tregu” (Prodi 2003b).

³ Shihni Qeveria e Shqipërisë (2001) dhe, për eksperiencat e kohëve të fundit në implementimin e masave të strategjisë, Qeveria e Shqipërisë (2003) dhe IMF (2003b).

dobëta. Megjithatë, investimet publike rregulluese, të cilat priteshin të gjeneronin shumë efekte të rëndësishme, prezumojnë hyrjen në sa më shumë burime buxhetore. Meqënëse Shqipërisë mund të mos i jepet e drejta për burime të rëndësishme financimi të huaj të lartë koncensional, kjo gjendje tashmë mjaft kritike bëhet edhe më urgjente. Problemet e kohëve të fundit në grumbullimin e të ardhurave, siç evidentohet nga raporti i të ardhurave vazhdimisht të ulëta ndaj PBB-së dhe nga deficitet e përsëritur në lidhje me parashikimet fillestare të buxhetit (FMN 2003a), rrisin shqetësimin nëse (dhe në çfarë kushtesh), është e arsyeshme të pritet që realizimi i qëllimeve ambicioze për zhvillimin e Shqipërisë, përfshirë ruajtjen e vazhdueshme të stabilitetit makroekonomik, mund të arrihet realisht brenda kufijve kohorë të përcaktuar nga SKZHES.

Rrjedhimisht, masat e politikës, të përcaktuara për të rritur të ardhurat buxhetore, mbeten në qendër të çdo strategjie zhvillimi në Shqipëri, duke përcaktuar sfidën e madhe – por sigurisht jo unike – që po has qeveria; pra, për të forcuar njëkohësisht grumbullimin e të ardhurave, për të përmirësuar shërbimet publike dhe marrëdhëniet e tendosura të takspaguesit me sektorin formal privat. Kjo është e mundur; dhe është treguar suksesshëm nga ekonomi të tjera në tranzicion, veçanërisht ekonomi të vogla. (për shembull, vendet Baltike). Siç do të argumentohet edhe më pas, një përgjigje ndaj këtyre eksperiencave në Shqipëri presupozon një korrigjim të konsiderueshëm ndaj elementeve kyç të regjimit ekonomik në fjalë. Siç ka thënë në mënyrë të përmbledhur Alesina (1999):

“Përmirësimi i performancës së qeverisë për arritjen e qëllimeve sociale do të thotë kalimi nga një ekonomi që i shmanget taksave, pa infrastrukturë dhe me rrjete sigurie të keqdrejtura, në një ekonomi formale taksapaguese, me rrjete sigurie sociale të efektshme, ndonëse relativisht të vogla. Megjithatë, shumë nga këto reforma nuk ka gjasa të jenë të suksesshme pa reduktuar korrupsionin dhe ineficiencën burokratike...”

Karakterizimi i Alesinas i një qeverie që është shumë e vogël dhe shumë e paefektshme për të përmirësuar ndjeshëm mjedisin socio-ekonomik i ka rrënjët në literaturën gjithnjë e në rritje për tregjet joformale;⁴ veçanërisht, në studime embrionale nga Loayza (1997) dhe Johnson, Kaufmann dhe Shleifer (1997), të cilët argumentojnë se ekonomitë me sektorë të mëdhenj joformalë tentojnë të mbërthehen në një ekuilibër “të keq” me mallra publikë të një cilësie të dobët dhe me një shkallë të lartë të evazionit fiskal. Duke analizuar një numër të madh ekonomish në tranzicion në Evropën Lindore dhe ish-Bashkimin Sovietik (përfshirë Shqipërinë), është gjetur se bizneset reagojnë ndaj një shkalle të lartë “të politizimit” të veprimtarive të sektorit privat⁵, me një tërheqje të tendencës prej sektorit formal, duke nënkuptuar që

⁴ Për një shqyrtim të literaturës korresponduese, shihni, për shembull, Schneider and Enste (2000a,b).

⁵ Johnson, Kaufmann dhe Shleifer (1997) përcaktojnë politizimin e jetës ekonomike si “ushtrim nga ana e politikaneve e të drejtave të kontrollit mbi bizneset ... Në mënyrë tipike, politikanët i përdorin këto të drejta për të ndjekur vetë interesat e tyre, si ruajtja e punësimit në firma të caktuara, mbështetja e sipërmarrësve politikisht miqësorë dhe dënimi i atyre që janë politikisht jomiqësorë, dhe subvencionimi i aleatëve të tyre. Politikanët i përdorin këto të drejta gjithashtu, për të pasuruar vetveten, duke u ofruar firmave lehtësi nga rregulloret në këmbim të rryshfeteve. Kontrolli politik përgjithësisht pakëson

stabilizimi makroekonomik pa reforma shoqëruese për forcimin e institucioneve mbështetëse të tregut nuk mjafton për ruajtjen e normave të larta të rritjes ekonomike. Ashtu si edhe shumë autorë të tjerë, Friedman et al. (2000) e argumenton këtë gjetje, duke treguar se “lirshmëria në zbatimin e rregullave, dhe korrupsioni që rrjedh prej saj, duket se kanë një efekt më të rëndësishëm” (f. 481) sesa, për shembull, normat më të larta marzhinale të taksave, të cilat shpesh citohen si një arsye kryesore për sektorë joformalë të mëdhenj.

Krahas kënaqësisë që rrjedh nga puna hulumtuese e nevojshme për të vlerësuar elementet “e fshehura” të veprimtarive ekonomike, një pjesë e madhe e kësaj literature motivohet nga përpjekja për të identifikuar efektet e informalitetit ekonomik në rritjen dhe në prosperitetin ekonomik. Shumë studiues kanë gjetur një korrelacion negativ ndërmjet këtyre dy variablave,⁶ kryesisht për tre arsye. Së pari, një sektor joformal i lartë çon në një rritje të aktiviteteve ekonomikisht joproductive (veçanërisht në fshehjen, në mbrojtjen ose në zbulimin e aktiviteteve ekonomike të fshehta të ligjshme dhe të paligjshme) dhe më pas në një humbje të konsiderueshme të burimeve të rralla (Shleifer and Vishny 1993). Së dyti, ai tenton të shkaktojë një keqshpërndarje të faktorëve të prodhimit, kryesisht sepse ndërmarrjet joformale – që nuk janë në gjendje të përdorin (plotësisht) institucionet mbështetëse të tregut, si policia, gjykatat, apo bankat —përdorin pamjaftueshëm teknologjinë e prodhimit intensiv të kapitalit, gjë që do t'i bëjë mallrat dhe shërbimet e tyre përfundimisht jokonkurruese (de Soto 1989). Së fundi, një ekonomi joformale e madhe rezulton në një shumë të konsiderueshme të ardhurash taksore të pagrumbulluara (Loayza 1997), të cilat, veçanërisht në vende si Shqipëria —pakësojnë mirëqënien ekonomike, pasi investimet (sociale) në infrastrukturë, të cilat kërkohen urgjent, nuk mund të bëhen, duke frenuar kështu aktivitetet e sektorit privat.

Rrjedhimisht, për të vlerësuar potencialin e rritjes afatgjatë dhe afatmesme të një vendi dhe për të përcaktuar përparësitë e politikës, kuptimi i madhësisë së tregut joformal (në lidhje me aktivitetet formale) është mjaft i rëndësishëm. Ndryshe nga shumë vende të tjera në tranzicion, që kanë një literaturë të konsiderueshme, e cila siguron vlerësime të madhësisë së sektorëve të tyre joformalë, në Shqipëri është bërë shumë pak punë kërkimore për të përqasur madhësinë – dhe/apo përbërjen – e ekonomisë së fshehtë të saj (dhe për rrjedhojë, shtrirjen e plotë të evazionit fiskal). Një përjashtim i dukshëm është Schneider (2002), i cili përdori një metodë që kombinonte inputin fizik

përfitueshmërinë e bërjes së biznesit, dhe rrjedhimisht ndikon në anën e kundërt në sipërmarrjen dhe rritjen ekonomike” (faqet: 159–60).

⁶ Përjashtimet e dukshme përfshijnë Cassel (1986, f. 93) ose Gretschmann (1984, f. 120) të cilët argumentojnë se tregjet joformale përfaqësojnë përkatësisht një “zbutës ekonomik” ose “një stabilizues të huadhënit të fundit në radhë” që i lejon individët dhe firmat të përshtaten më lehtësisht në një mjedis ekonomik të përkeqësuar. Në studimin e tij empirik, Bhattacharyya (1993) tregoi se sektori joformal kishte efekte pozitive, si në konsum ashtu edhe në shpenzimet për investim për Mbretërinë e Bashkuar gjatë periudhës 1960–84, një pikë të cilën Schneider (1998) e mbështeti duke analizuar të dhëna gjermane dhe austriake. Autorë të tjerë, si Asea (1996), argumentojnë se pronarët e firmave joformale tentojnë të marrin më tepër rrezikun përsipër dhe, si rezultat, t'i japin ekonomisë një shkallë më të lartë konkurrence, duke pasqyruar kështu idealin e Schumpeter's (1942) për një sipërmarrje novatore dhe krijuese.

(elektricitetin), kërkesën për para, dhe metodat e bazuara në model⁷ për të vlerësuar ekonominë e fshehtë të Shqipërisë. Me paralajmërimin e “shifrave të pabesueshme” (shihni shënimi në tabelën 5, f. 14), ai vlerësoi se gati një e treta e veprimtarive ekonomike totale në vitin 2000 ishte joformale.⁸ Kjo shifër është e krahasueshme me atë të përdorur nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) kur llogariten shifrat zyrtare të PBB-së.⁹ Megjithatë, media shqiptare ka sugjeruar vazhdimisht se madhësia e sektorit joformal në të vërtetë mund të jetë mjaft e lartë.¹⁰ Kjo kumtesë do të shqyrtojë disa tregues makroekonomikë dhe do të diskutojë nëse ata vërtet mund të jenë në përputhje me sugjerimin e një sektori joformal më të madh se vlerësimi aktual.

2. Sektori Joformal dhe Zhvillimi Ekonomik

Përkufizimi i Sektorit Joformal

Ka një debat të madh akademik lidhur me përkufizimin “e saktë” të *ekonomisë joformale*, një diskutim i hollësishëm që kapërcen qëllimet e këtij kapitulli.¹¹ Në këtë kumtesë, termi “ekonomi joformale” do të përcaktohet për të përfshirë aktivitetet ekonomike “të fshehta” dhe “të paligjshme”, të ardhurat e të cilave duhet të ishin raportuar në autoritetet tatimore, por që janë fshehur prej tyre – për arsyet e mëposhtme:

Së pari, ekonomia “e fshehtë” përfshin aktivitete që, përveç shkeljes së ligjit të taksave, janë kryesisht të ligjshme, si sipërmarrjet e vogla të palicencuara, tregtinë barter të paregjistruar, nënfaturimin dhe kontrabandën e mallrave jo të ndaluar. Kështu, këto lloje aktivitetesh shihen si një problem i evazionit fiskal që përfaqëson një sfidë jetësore për vendimmarrjen ekonomike. Së dyti, sektori joformal është përcaktuar se përfshin gjithashtu ato aktivitete që, nga vetë natyra e tyre, janë “të paligjshme”. Si rezultat, konsiderohen edhe aktivitetet e krimit (ekonomik) të organizuar¹²— të cilat përfshijnë kryesisht trafikimin e armëve, të drogës dhe të grave, gjithashtu. Ndërkohë që kjo përfaqëson, para së gjithash, një problem të zbatimit të ligjit, ky përkufizim do të përdoret për të lejuar studime vijuese të vlerësojnë madhësinë relative të aktiviteteve joformale që mbështeten në të dhëna makroekonomike; këto lloje analizash natyrisht që do të hasin pengesa shtesë, në qoftë se do të duhej të ndanin ato aktivitete, që parimisht janë të ligjshme nga ato të paligjshme.¹³ Në

⁷ Për një diskutim lidhur me teknikat e ndryshme të vlerësimit, shihni artikujt e ndryshëm të përfshirë në qershor të vitit 1999 në diskutimin e *Gazetës Ekonomike* për “Polemika: Mbi ekonominë e fshehtë” si dhe *Schneider and Enste* (2000b), *Tanzi* (1986) dhe *Feige* (1986) dhe autorët e cituar në ta.

⁸ Sipas metodës së vlerësimit të Schneider’s (2002), madhësia e sektorit joformal në Shqipëri është e krahasueshme me atë të Lituanisë (30.3 për qind), të Kroacisë (33.4 për qind), të Bosnjës dhe Hercegovinës (34.1 për qind), të Rumanisë (34.4 për qind) dhe të Bullgarisë (36.9 për qind).

⁹ Vlerësimi i INSTAT-it bazohet në një metodë vrojtimi që analizon aktivitetet ekonomike të bizneseve të mëdha, të mesme dhe të vogla në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

¹⁰ Gazeta e përditshme në 16 dhjetor 2002, për shembull, përmend në faqen 1 se 50–60 për qind e ekonomisë shqiptare është joformale, me kontrabandën e mallrave të importuar si komponenti kryesor (“Ekonomia, 60 përqind joformale”).

¹¹ Për një diskutim të hollësishëm për avantazhet dhe kufizimet e përkufizimeve alternative, shihni, për shembull, Schrage (1984) and Thomas (1992).

¹² Shihni gjithashtu Altvater dhe Mahnkopf (2002) dhe Naylor (2002).

¹³ Për shembull, si do të ndante dikush pjesën e vogël të transfertave private *cash* që përfaqësojnë remitancat në kuptimin e ngushtë të termit nga ato që korrespondojnë me përfitimet e përfuara në mënyrë të pandershme?

vijim, “sektori joformal” do të përcaktohet si shumë e të gjitha aktiviteteve tregtare të padeklaruara që, *de facto*, kontribuojnë në të ardhurat kombëtare.


Meqënëse pjesëmarrja në ekonominë joformale përfaqëson një dhunim të normave ligjore (edhe në qoftë se aktivitetet janë në vetvete të ligjshme), aktivitetet jozyrtare tentojnë të shoqërohen nga një nivel i rritur i korrupsionit publik, ku nëpunësit (e paguar pak) pranojnë ryshfete në këmbim të mbrojtjes apo të favorizimeve, në dëm të shtetit. Në vitet e fundit, është krijuar një literaturë mjaft e gjerë që tregon se, në një sistem të rrënjosur në ryshfete dhe korrupsionin, iniciativat ekonomike shtrembërohen, pasi nëpunësit e qeverisë dhe individët privatë të favorizuar, marrin një pjesë më të madhe të përfitimeve publike ose mbajnë një pjesë më të ulët të kostos së mallrave publike” (FMN 2000, f.130), gjë që rezulton në më pak investime private, në më pak të ardhura qeveritare, ndërkohë që rritet pabarazia dhe varfëria. Shihni Mauro (1995), *Tanzi and Davoodi* (1997, 2000), Gupta et al. (1998), dhe *Abed and Gupta* (2002), me argumentat - kyç të përmbledhur mirë në Tanzi (1998). Shumica e studimeve të fundit konfirmojnë ekzistencën e korrelacionit negativ ndërmjet korrupsionit dhe rritjes, duke theksuar kështu rëndësinë e “qeverisjes” së përmirësuar, si një element themelor në programet e suksesshme të reformave ekonomike.

“Kurthi” i informalitetit

Për një politikëbërës, aspekti më i vështirë i kthimit nga ana tjetër të tendencës së rritjes së madhësisë relative të tregut joformal është pranëvënia e *përfitimeve private* dhe *kostove publike*. Siç përmbledhet në figurën 1, çdo pjesëmarrës i tregut në ekonominë joformale përfiton – direkt dhe personalisht – në disa mënyra: (i) individët tentojnë të marrin rroga më të larta neto nga taksat dhe janë në gjendje të blejnë mallra privatë dhe shërbime me çmime më të ulëta; (ii) firmat mund të prodhojnë me më shumë konkurrencë pa ndërveprimin e kushtueshëm dhe shpesh që humb kohë me nëpunësit e qeverisë; dhe (iii) nëpunësit dhe politikanët e korruptuar marrin të ardhura private shtesë (ryshfete) në shkëmbim të plotësimin (të dëshirave) të atyre që marrin pjesë dhe që përfitojnë prej ekonomisë joformale. Në kontrast me këtë, kostot korresponduese janë të gjitha “publike” prej natyre. Ato përfshijnë kryesisht të ardhura fiskale të pakësuara dhe, rrjedhimisht, shpenzime më të ulëta për mallrat publik përgjithësisht të vlerësuar, si spitalet, shkollat, universitetet, rrugët apo furnizimin e vazhdueshëm të energjisë dhe të ujit.

Ndërsa në parim, individët, firmat dhe nëpunësit e qeverisë e kuptojnë se të gjithë do të përfitonin nga një mjedis më “i formalizuar”, me një shkallë të ulët evazioni fiskal dhe të mira dhe shërbime publike me cilësi. Megjithatë, për shkak të këtij konflikti ndërmjet përfitimeve private dhe kostove publike, asnjë aktor ekonomik nuk është vërtet i gatshëm të ndërmarrë “vullnetarisht” hapin e parë në drejtim të rritjes së formalizimit ekonomik. Reduktimi i sigurt i përfitimeve private që rrjedhin nga aktivitetet joformale, peshon më tepër sesa pritjet e pasigurta për përmirësime në sigurimin e të mirave publike. Pra, ekonomitë që kanë një sektor të madh joformal tentojnë të ngecen në një rreth vicioz (Alesina 1999),

Figurë 1. Ekonomia duale e stilizuar.




ku shkalla e lartë e informalitetit e vështirëson detyrën e qeverisë për grumbullimin e të ardhurave për buxhetin. Me të ardhura të ulëta nga taksat, shpenzimet për shërbime të rëndësishme publike do të jenë gjithashtu të ulëta, që nga ana e tyre, do të reflektoheshin në cilësinë e tyre nënstandarde (duke ndikuar kështu në tkurrjen e investimeve në sektorin privat). Me një sektor publik joeficient, disiplina e taksapaguesve do të mbetet e ulët, duke e lënë ekonominë të ngecur në një kurth fiskal. (Figurë 2).

Kushtet për kthimin e tendencës

Ekonomistët tentojnë të përfaqësojnë një situatë të tillë në *një model ekuilibri dual*, në të cilin një ekonomi pa veprime të besueshme, të vendosura dhe të koordinuara me të gjithë pjesëmarrësit e tregut, nuk do të jetë në gjendje të gjejë “automatiksht” një rrugë drejt rezultatit më të mirë, me një shkallë të ulët evazioni dhe me cilësi të lartë të të mirave publike. Edhe në ekonominë e tregut të lirë, i vetmi aktor në gjendje për të filluar dhe për të bashkërenduar masat e nevojshme, mbetet qeveria. Interpretimi i ekuilibrit dual të ekonomive me sektorë të mëdhenj joformalë nënkupton se – me politikën “e gabuara”

(ose pa politika fare) – një ekonomi mund të përqëndrohet në një ekuilibër me sektor joformal të madh, dhe më pas “të ngecet” në të, me një normë të dobët të grumbullimit të taksave, të ardhura të ulëta nga taksat, dhe shërbime të dobëta publike, duke nxitur iniciativat ekonomike (të vazhdojnë) të veprojnë jo në mënyrë formale. Vendosija e diskutimit për implikimet e rritjes së një ekonomie të madhe joformale në një kuadër ekuilibri dual do të thotë që një ekonomi kërkon një impuls për të gjetur rrugën virtuoze drejt rezultatit “superior”. Një stimul kaq i besueshëm, mjaft i fuqishëm për të ndryshuar sjelljen e njerëzve, do të duhej të kombinonte angazhimin politik

Figurë 2. Rrethi vicioz.



(të besueshëm) të qeverisë për reformë, me njohjen e agentëve ekonomikë të një mjedisi të përgjithshëm të ndryshuar. Bisedimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, me orientimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, mund të përfaqësonin konceptualisht një ngjarje mjaft të rëndësishme, për të lejuar implementimin e masave politike, shpesh shumë të vështira, por të nevojshme për të kthyer në drejtim të kundërt rritjen e tendencës së informalitetit ekonomik. Në këtë detyrë, sfida kryesore lidhet në mënyrë tipike me nevojën për të bërë reforma strukturore të implementuara në shpenzim të interesave vetjak tipikisht të lidhur mirë.

Duke parë eksperiencën e vendeve të tjera në tranzicion, nuk është e habitshme të shihet një lidhje e mundshme midis përpjekjeve për t'u bashkuar me Bashkimin Evropianë dhe një rënieje në aktivitetin joformal. Për shembull, kur merren vlerësimet e sektorit joformal nga Johnson, Kaufmann dhe Shleifer (1997) dhe ripërshtaten ato sipas statusit të vendit kundrejt Bashkimit Evropian, bëhet e qartë se një rënie në madhësinë relative të ekonomive të fshehta është vërejtur në ato vende që priteshin të bashkoheshin me Bashkimin Evropian në “valën e parë” të zgjerimit (shihni tabelën 1). Ndërkohë që shifrat nuk përcaktojnë shkakësi, implikimi i tendencës pothuajse uniformë

të ndryshimit të tendencës në madhësinë relative të tregut joformal në vendet që priteshin të pranoheshin në Bashkimin Evropian gjatë mesit të viteve 1990, do të ishte në pajtueshmëri me implikimet e politikës të një shpjegimi të ekuilibrit dual të aktiviteteve të tregut joformal.

Disa ekonomistë ¹⁴ kanë argumentuar se struktura e iniciativave ekzistuese në ekonomi me sektorë të mëdhenj joformalë – duke i ngjarë “dilemës së të burgosurit” të diskutuar në teorinë e lojës – i largon aktorët ekonomikë nga ndryshime të papritura (të paprovokuara) në drejtimin e tyre, për një argument të thjeshtë të *ekonomisë politike*: Meqënëse pjesëmarrës të veçantë në ekonominë e fshehtë, ndonëse në formën e një punëtori, konsumatori, votuesi apo taksapaguesi, përfitojnë nga *statukuoja*¹⁵ po aq sa firmat përfitojnë nga kostot e punës relativisht më të ulëta, nga rregulloret dhe nga detyrimet taksore, politikanët e zgjedhur nuk kanë iniciativë të propozojnë një reformë që të pakësojë avantazhin ekonomik të zgjedhësve të tyre. Kështu, një strategji e synuar

¹⁴ Shihni , për shembull, Hofreither and Schneider (1989) ose Kapitullin 9 në Schneider and Enste (2000).

¹⁵ Nën kushtet gjithçka tjetër e pandryshueshme (*ceteris paribus*), pjesëmarrja në tregun joformal rrit pagat neto dhe maksimizon konsumin e mallrave privat, subjekt i kufizimeve të buxhetit të familjarëve.

Tabelë 1. Ekonomitë në tranzicion: madhësia e vlerësuar e sektorit joformal
(Në përqindje ndaj PBB-së; në qoftëse nuk tregohet ndryshe)

	1995 Popullsia (në milion)	1990	1993	1995
Vendet e pranimit në BE*		17.4	20.7	15.5
Republika Çeke	10.3	6.7	16.9	11.3
Estonia	1.5	19.9	24.1	11.8
Hungaria	10.2	28.0	28.5	29.0
Latvia**	2.5	12.8	31.0	35.3
Lituania**	3.7	11.3	31.7	21.6
Polonia	38.6	19.6	18.5	12.6
Republika Sllovaqe	5.4	7.7	16.2	5.8
Vende të tjera në tranzicion*		15.8	35.8	41.8
Azerbaixhani	7.7	21.9	51.2	60.6
Bullgaria	8.4	25.1	29.9	36.2
Gjeorgjia	5.4	24.9	61.0	62.6
Moldavia	4.4	18.1	34.0	35.7
Rumania	22.7	13.7	16.4	19.1
Rusia	148.1	14.7	36.7	41.6
Ukraina	51.7	16.3	38.0	48.9

Burimi: Johnson, Kaufmann and Shleifer (1997, f. 183).

* Peshuar sipas popullsisë (IMF, 2001b).

** Fillimisht jo të konsideruara si një "raund i parë" i vendit të pranimit.

Tabelë 1. Ekonomitë në tranzicion: madhësia e vlerësuar e sektorit joformal
(Në përqindje ndaj PBB-së; në qoftë se nuk tregohet ndryshe).

	1995 Popullsia (në milion)	1990	1993	1995
Vendet e pranimit në BE*		17.4	20.7	15.5
Republika Çeke	10.3	6.7	16.9	11.3
Estonia	1.5	19.9	24.1	11.8
Hungaria	10.2	28.0	28.5	29.0
Latvia**	2.5	12.8	31.0	35.3
Lituania**	3.7	11.3	31.7	21.6
Polonia	38.6	19.6	18.5	12.6
Republika Sllovaqe	5.4	7.7	16.2	5.8
Vende të tjera në tranzicion*		15.8	35.8	41.8
Azerbaixhan	7.7	21.9	51.2	60.6
Bullgaria	8.4	25.1	29.9	36.2
Gjeorgjia	5.4	24.9	61.0	62.6
Moldavia	4.4	18.1	34.0	35.7
Rumania	22.7	13.7	16.4	19.1
Rusia	148.1	14.7	36.7	41.6
Ukraina	51.7	16.3	38.0	48.9

Burimi: Johnson, Kaufmann, and Shleifer (1997, f. 183).


* Peshuar sipas popullsisë (IMF, 2001b).

** Fillimisht jo i konsideruar si një vend pranimi “i raundit të parë”.

për formalizimin e aktiviteteve ekonomike ka vetëm një shans për të qenë e suksesshme: në qoftë se kostot korresponduese të ndryshimit të sjelljes së dikujt janë mëse të kompensuara nga (i) (pritja e) një shkurtimi taksash shoqërues; (ii) përmirësimi në mallrat publik të disponueshëm; dhe (iii) përfitime të tjera të prekshme (si një anëtarësim i mundshëm në Bashkimin Evropian brenda një të ardhmeje të parashikueshme).

Rrjedhimisht, vendimi racional i firmave nëse të operojnë apo jo (plotësisht) në ekonomi formale varet nga kundërtia ndërmjet përfitimeve nga mundësia e hyrjes (së papenguar) në mallra publik – dhe/apo përfitime të tjera të radhitura më lart – dhe kostove private për pagimin e taksave dhe pajtueshmërisë me rregulloret (neto nga rreziqet bashkëshoqëruese të zbulimit dhe gjobitjes). Rrjedhimisht, politikat e caktuara për të (ri) integruar ekonominë e fshehtë me ekonominë formale duhet t’i drejtohen problemit të “shoferit të lirë”, që lejon sipërmarrjet joformale të përfitojnë nga (një numër i caktuar) mallrash publik pa kontribuar në sigurimin e tyre, dhe një dilemë “e mosuksesit të koordinuar” à la Cooper and John (1991), sipas tipizimit të shkurtër të të cilit “fitimet reciproke nga një ndryshim i përgjithshëm në strategji mund të mos realizohen, sepse asnjë lojtar nuk ka iniciativë të devijojë nga ekuilibri fillestar” (fq. 4). Në qoftë se pika e fillimit është një ekuilibër nënoptimalen (në këtë rast, një vend me sektor publik joeficient, që siguron një shumë të pamjaftueshme të mallrave publik të cilësisë së dobët), sipërmarrjet janë të gatshme të regjistrojnë aktivitetet e tyre dhe të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe me rregulloret *vetëm në qoftë se* ata ndjehen mjaft të sigurtë që konkurrentët e tyre përkatës do t’iu përmbahen atyre, gjithashtu. Ndryshe, kostoja e përputhshmërisë do të vazhdojë të tejkalojë përfitimet e saj.

Figurë 3. Zhvillime në të ardhurat nga taksat, 1989-2002.



Burimi: Tanzi and Tsibouris (2000, f. 18) dhe raporte vendi të ndryshme të FMN-së.

Ekonomia joformale në Shqipëri

Vlerësimi i detajuar dhe i besueshëm i madhësisë dhe i përbërjes së tregut joformal në Shqipëri — duke konsideruar natyrën e kufizuar të të dhënave edhe për aktivitetet e sektorit formal — është, pa dyshim, një ushtrim shumë sfidues, dhe nevojitet punë e mëtejshme kërkimore.¹⁶ Kjo kumtesë do të kufizohet në mënyrë joambicioze në një shqyrtim të treguesve të rëndësishëm makroekonomikë, që do të ndihmojnë për të kuptuar më mirë situatën në Shqipëri. Siç u përmend edhe në hyrje, vlerësimet korrente të PBB-së përfshijnë një vlerësim të aktivitetit joformal në një të tretën e prodhimit të përgjithshëm. Megjithatë, të dhënat për grumbullimin e taksave, sugjerojnë se ky vlerësim paraprak mund të jetë më së miri në anën e ulët. Figura 3 përmbledh ndryshimet - kyçe në grumbullimet e të ardhurave nga taksat ndërmjet disa vendeve në rajon. Ndërkohë që edhe vendet në tranzicion me ecuri relativisht të dobët në Evropën Juglindore ia dolën mbanë të grumbullonin të ardhurat nga taksat, përfshirë kontributet shoqërore, prej rreth 30 për qind të PBB-së gjatë viteve 2000–02 (tabela 2), shifrat korresponduese për Shqipërinë qëndruan në më pak se 20 për qind, pavarësisht nga përmirësimi gradual – por i qëndrueshëm në grumbullimin e taksave që në vitin 1997. Ende, vetëm një pjesë relativisht e vogël e humbjes në kapacitetin

¹⁶ Për një diskutim për metodat indirekte të përdorura për të përafëruar madhësinë e ekonomive të fshhta, shihni, për shembull, Feige (1989) dhe Schneider dhe Enste (2000a). Johnson, Kaufmann dhe Shleifer (1997), Lackó (2000) dhe Schneider dhe Enste (2000b), që japin vlerësime për ekonomi të tjera në tranzicion.

e zbatimit të hasur në periudhën 1991–'92 mund të rimëkëmbet.¹⁷ Siç tregon figura 4, arsyeja për ndryshim të konsiderueshëm në ecuri nuk është niveli i normave të taksave të caktuara në Shqipëri (të cilat janë të krahasueshme me ato të vendeve fqinjë) por është diferenca në eficientë e grumbullimit të taksave.

Tabelë 2. Të ardhurat nga taksat, 2000-'02


(Në përqindje të PBB-së)

	2000		2001		2002	
	taksat, doganat, sigurimi shoqëror	prej të cilave sigurimi shoqëror	taksat, doganat, sigurimi shoqëror	prej të cilave sigurimi shoqëror	taksat, doganat, sigurimi shoqëror	prej të cilave sigurimi shoqëror
Shqipëria	18.9	3.6	19.0	3.7	19.0	3.8
Bosnje-Herzegovina	42.6	15.9	40.2	14.7	41.6	15.2
Bullgaria	29.9	8.3	28.7	7.8	27.4	7.3
Kroacia	42.1	13.3	41.2	13.2	41.1	12.5
Maqedonia, FYR	33.0	10.6	31.9	10.8	34.0	10.6
Moldavia	22.3	5.6	22.4	6.3	--	--
Rumania	29.2	10.8	28.0	10.7	27.6	10.7
Federata Ruse	35.3	7.9	34.9	7.4	34.9	7.7
Serbia-Mali i Zi	35.3	12.5	35.5	11.1	39.4	10.6
Sllovenia	39.6	13.7	39.4	13.6	37.4	13.4

Burimi: Raporte vendi, të ndryshme të FMN-së.

¹⁷ Rënia shumë e mprehtë në grumbullimin e të ardhurave tatimore në vitin 1991–'92, me rreth 25 pikë përqindjeje ndaj PBB-së, u shkaktua nga kolapsi ekonomik dhe anarkia sociale pas 48 vjet të komunizmit dhe izolimit (për një analizë gjithëpërmbljedhëse të sfidave të veçanta gjatë viteve të para të tranzicionit, shihni, për shembull, Blejer et al., 1992).

Figurë 4. Eficienca në grumbullimin e taksave



Burimi: Raporte vendi të ndryshme të FMN.

Tabelë 2. Shpeshtësia dhe shtrirja e "taksës rryshfet" .


	Përqindja e firmave që bëjnë shpesh rryshfete		Taksa mesatare e rryshfetit si përqindje e të ardhurave vjetore të firmave	
	1999	2002	1999	2002
Shqipëria	46.7	36.4	1.7	3.3
Bosnje-Herzegovina	20.5	22.4	2.1	0.9
Bullgaria	23.0	32.8	1.3	1.9
Maqedonia	33.0	22.7	1.4	0.8
Silovenia	7.7	7.1	1.0	0.8

Burimi: EBRD (2002, f. 28).

Kontrabanda e përhapur, mosraportimi i rregullt i faturave, falsifikimi i bilanceve dhe një dobësi e përgjithshme në zbatimin e ligjit për taksat kanë përcaktuar, deri tani kufijtë në grumbullimin e të ardhurave vendase dhe, rrjedhimisht, mundësinë e qeverisë për të siguruar mallra publik në nivel të mjaftueshëm (dhe në cilësi të kënaqshme). Po të bëjmë analizën e shifrave në bazë taksë pas takse (përsëri, shihni figurën 4), shihet se taksat me ecur

më të dobët në Shqipëri janë kontributet e sigurimeve shoqërore. Me norma disi më të larta, Shqipëria arriti të mbledhë rreth 3.8 për qind të PBB-së në vitin 2002 krahasuar me 7.3 për qind të Bullgarisë apo 10.7 për qind të Maqedonisë. Është inkurajuese të shohësh se autoritetet shqiptare kanë reaguar dhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit, kanë filluar hartimin e një plani për transferimin e mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore në degën e taksave, duke lejuar që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përqëndrojë përpjekjet e tij në përmirësimin dhe në përcaktimin e përfituesve të sigurimeve shoqërore.

Figurë 5. Rëndësia e parasë vendase *cash*, 1998-2002.



Burimi: Raporte Vendi të ndryshme të FMN.

Megjithatë, dobësitë administrative janë vetëm një pjesë e arsyeve që shpjegojnë diferencat midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj. Problemet e qeverisjes mbeten një pengesë serioze. Për shembull, *Raporti i Tranzicionit* të vitit 2002 të BERZH-it tregoi se, ndërkohë që ra disi përqindja e firmave që mbështeteshin në “nxitjen” për para, “taksa mesatare e ryshfetit” që firmat paguanin pothuajse u dyfishua gjatë viteve 1999- 2002 në 3.3 për qind të të ardhurave (tabela 3), duke e vënë Shqipërinë në një pozicion jo shumë të këndshëm, në afërsi të Republikës së Kirgistanit, të Azerbaixhanit dhe të Gjeorgjisë. S’është habi që administrimi -shpesh arbitrar dhe përgjithësisht joeficient në dogana dhe në departamentet e taksave- është identifikuar kohët e fundit nga një studim gjithëpërmblëdhës për barrierat ndaj investimeve si një parandalues kryesor ndaj investimit të huaj. Kombinimi, në kontekstin rajonal, i normave mesatare të taksave, grumbullimi i ulët i të ardhurave dhe “ryshfetet e larta në taksa” sigurisht që përputhet me një ekonomi të madhe të fshehtë.

Tregues të tjerë mund të gjenden kur analizohen të dhëna monetare të kohëve të fundit. Aktivitetet ekonomike joformale tentojnë të bazohen në *cash* (*cash* është anonim) dhe kërkesa për *cash*, lidhur me prodhimin e

përgjithshëm, është përdorur shpesh për të përfaqësuar zhvillime në sektorin joformal të ekonomisë – veçanërisht në qoftë se kërkesa për *cash* rritet me ritëm më të shpejtë sesa konsiderohet e justifikuar nga bazat themelore ekonomike. Në këtë kontekst, mbajtjet e larta në *cash* për kapital dhe veçanërisht një rritje në kërkesën për *cash* me 3 pikë përqindjeje të PBB-së gjatë viteve 1998–2002, mund të meren si një tregues i këtij zhvillimi. (Figura 5.) Megjithatë, studime të mëtejshme dhe më të hollësishme do të duheshin të (i) ndanin kërkesën për *cash* prej pasojave dhe ndryshimeve të sjelljes nga kolapsi i firmave piramidale në vitin 1997 dhe nga episodi i tërheqjes së depozitave në fillim të vitit 2002; (ii) të identifikonin lidhjen e mbajtjeve të *cash*-it dhe depozitave, në dritën e rënies së lartë të normave reale të interesit gjatë kësaj periudhe; dhe (iii) të përfshinin vlerësime të qarkullimit të parave të huaja *cash* në ekuacion. Nisur nga niveli i të ardhurave në Shqipëri, bashkë me qarkullimin e një shume të konsiderueshme të parasë së huaj në *cash*, shuma për frymë e parasë vendase në *cash*, në kohë dhe në krahasim me vendet fqinje, është shumë e lartë, dhe, *a priori*, do të dukej se mbështeste supozimin e një sektori joformal që është më i lartë se shifrat zyrtare (dhe më i lartë se ato të vendeve fqinje).

Këto të dhëna në nivel makro lejojnë një përafrim paraprak të madhësisë së vlerësuar të tregut joformal në Shqipëri. Duke pohuar se pjesa e sektorit joformal ndaj PBB-së në Bullgari është afërsisht e saktë (shihni tabelë 1) dhe duke konsideruar një barë takse efektive prej rreth 50 për qind¹⁸, diferenca prej 8½ pikësh përqindje në normat e grumbullimit të taksave ndërmjet dy vendeve (shihni figurën 3) do të nënkuptonte që shumica e aktiviteteve ekonomike në Shqipëri, në fakt, mund të jenë joformale. Kjo është një hipotezë dhe në asnjë mënyrë nuk është një vlerësim (provë), bazuar në analizën e treguesve të ndryshëm, që, megjithatë, duket se pajtohen me këtë pretendim. Kjo duhet të konfirmohet (ose të refuzohet) nga studime të hollësishme empirike.

4. Formalizimi i ekonomisë së fshehtë: Masat e rekomanduara.

Sektori joformal i Shqipërisë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të aktiviteteve ekonomike dhe mund të rrezikojë lehtësisht realizimin e objektivave afatmesëm të Shqipërisë për zhvillimin socioekonomik dhe për integrimin evropian. Ndërkohë që të ardhurat buxhetore, lidhur me ecurinë e ekonomisë së Shqipërisë janë të dobëta, aktivitetet e sektorit formal privat dekurajohen nga: (i) lidhjet e tendosura të taksapaguesit; (ii) zbatimi i pamjaftueshëm i taksave; (iii) leja e tepërt dhe kërkesa licencuese; (iv) ekzistenca e disavantazhit konkurrues lidhur me pjesëmarrësit e tregut joformal; dhe (v) një infrastrukturë publike të dobët.

Për ta larguar Shqipërinë nga “ekuilibri nënoptimal” kërkohen përpjekje të bashkërenduara. Sfida kryesore e qeverisë në këtë etapë zhvillimi të

¹⁸ Për individët, norma mesatare e taksave mbi të ardhurat është rreth 18 për qind, me kontributin e punonjësve në institutin e sigurimeve shoqërore që përfaqëson 12 për qind. Në qoftë se nga 70 për qind të mbetur, treçereku është konsumuar, 11 për qind tjetër do të paguhen në TVSH dhe, rrjedhimisht, 7 për qind për akcizë. 2 për qind i mbledhur do të pasqyrojë taksat e tjera.

Shqipërisë, shtrihet në adoptimin e masave që synohen për përmirësimin e “qeverisjes” dhe për forcimin e institucioneve publike, përfshirë administrimin e doganave dhe taksave. Një strategji e suksesshme do të duhej të qëndronte në dy shtylla – pra (i) duke siguruar “mallra publik” më të mirë (domethënë, duke përmirësuar qeverisjen, cilësinë e shërbimeve publike dhe marrëdhëniet e taksapaguesve, duke shpejtuar implementimin e investimeve të SKZHES, dhe duke siguruar progres në negociatat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit); dhe (II) zhvillimin e një plani veprimi të besueshëm antievazion.

Në rastin e Shqipërisë, nuk ka norma të larta taksash në vetvete por, në një shkallë të madhe, është zbatimi jo i efektshëm dhe sipas dëshirës i ligjeve të taksave dhe rregulloreve qeveritare që ka krijuar kushtet nën të cilat ekonomia e fshehtë po rritet. Rrjedhimisht, qeveria duhet të gjejë rrugën për të rritur ndërgjegjësimin publik për angazhim në rritje të qeverisë për t’iu drejtuar me vendosmëri evazionit fiskal (i cili, në vetvete, duhet të ndihmojë në përmirësimin e disiplinës për taksat, ndërkohë që përmirësohen marrëdhëniet me taksapaguesit. Autoritetet mund ta arrijnë këtë gjë, për shembull, duke organizuar seminare (apo sesione për marrje idesh) që do t’u mundësojnë të kuptohet (I) shumica e taksave të pambledhura; (II) kanalet kryesore të përdorura për evitimin e drejtorive doganore dhe tarifore); dhe (III) efektivitetin e masave të mundshme politike, që synojnë në mbylljen e shtigjeve. Pa dyshim, “lufta kundër evazionit” është një objektiv mjaft i gjerë dhe mjaft ambicioz, me pritjet e publikut për përmirësime reale të ulëta, për aq kohë sa ky qëllim i shprehur publikisht nuk mbështetet nga hapa praktikë për t’iu drejtuar çështjes mall pas malli, taksë pas takse dhe problem pas problemi. Përveç Ministrisë së Financave dhe drejtorive doganore dhe tatimore, disa palë të tjera kanë një interes të fuqishëm në përmirësimin e situatës, ndër të cilat më të rëndësishme janë sipërmarrjet formale që hasin një disavantazh kostoje të konsiderueshme në treg kundrejt konkurrentëve joformalë. Kështu, këshilla e tyre duhet të kërkohej në mënyrë aktive në çdo diskutim për një strategji të detajuar antievazion.

Nëse dikush merr një mall të veçantë akcize (cigare, lëndë djegëse, kafe apo pije alkoolike) apo një taksë specifike, sipërmarrjet formale që janë aktive në këto tregje, ka mjaft mundësi të përgjigjen shumë pozitivisht ndaj një ftese për t’u angazhuar në një dialog direkt me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Doganave dhe të Tatimeve për të (i) identifikuar burimin kryesor të humbjeve; (ii) diskutuar dobësitë përkatëse në administrimin publik; dhe (iii) propozuar masa të politikës për të ndrequr situatën. Gjithashtu, sistemi bankar –bashkë me drejtoritë e doganave dhe tatimeve - mund të mbështesë përpjekjet për të identifikuar rrugët për nxitjen e pagesave nëpërmjet sistemit bankar dhe për të lehtësuar, veçanërisht pagesat e doganave dhe tatimeve jo në *cash* ose nëpërmjet përdorimit të depozitave direkte (të themi, direkt në pikat e hyrjes në doganë), me çeqe të garantuara bankare, transferta direkte të parave ose nëpërmjet përdorimit të rritur (dhe të pranueshëm) të kartave të kreditit.

Në fund të një procesi të tillë konsultativ, propozimet rezultuese të politikës, bashkë me një program të vendosur, duhet të prezantohen publikisht, si një strategji antievazion, duke (i) rritur kështu ndërgjegjësimin publik të

angazhimit të qeverisë për t'iu drejtuar këtij problemi në një mënyrë serioze, gjithëpërmblendhëse dhe të detyrueshme, (ii) përkrahur përpjekjet në sigurimin e niveleve më të larta të të ardhurave; (iii) mbështetur objektivin e qeverisë në implementimin e qëllimeve afatmesme - kyçe të politikës si, për shembull, të identifikuar në SKZHES; dhe (iv) filluar të ndryshohet konceptimi i përhapur i evazionit si një rrugë “e pranueshme” e bërjes së biznesit duke komunikuar (njoftuar) kostot për vendin në tërësi, përfshirë efektet e tij në të ardhmen për anëtarësimin përfundimtar në Bashkimin Evropian.

Në hartimin e kësaj strategjie “të kulaçit dhe kërbacit” qeveria mund dhe duhet të mbështetet në çdo aktor ekonomik, që do të përfitonte nga një situatë e përcaktuar me një shkallë e ulët të evazionit fiskal dhe nga siguri i të mirave publike me cilësi të lartë. Këta mallra përfshijnë (i) ata punonjës të sektorit publik që kanë një interes të vërtetë në sigurimin dhe në rritjen e të ardhurave nga buxheti, në mënyrë që të përshpejtohet zbatimi i investimeve prioritare (çka do të rriste popullaritetin e atyre politikave që do ta mbikëqyrnin këtë reformë); (ii) një numër të madh biznesesh formale që kërkojnë një konkurrencë më të ndershme, shërbime më të mira publike dhe taksa më të ulëta në afat të mesëm dhe (iii) shumë individë (votues) që do të mirëpresin rrugë, shkolla, spitale më të mira dhe në përgjithësi një qeveri më efiçente dhe më përgjegjëse. Duhet mbajtur parasysh se ka dhe një numër të madh interesash vetjakë (privatë), si në sektorin publik dhe atë privat, të cilët herë pas here përfitojnë nga *statukuoja*. Këta duhet të sakrifikohen për hir të së mirës publike. Nuk është pra e çuditshme që çdo kërkesë e këtij tipi të jetë jopopullore dhe të hasë rezistencë aktive.

Megjithatë, duke e (i) ndarë problemin e madh në shumë probleme të vogla, (ii) sensibilizuar publikun se vërtet ka një angazhim serioz dhe të besueshëm nga qeveria për të arritur progres të ndjeshëm (i cili, në kontekstin e nisjes së bisedimeve për një Marrëveshje Stabilizim Asocimi, përbën një periudhë kohore mjaft bindëse për ta bërë një njoftim të tillë); dhe (iii) duke kërkuar në mënyrë eksplicite inputin e sektorit privat, qeveria duhet të jetë në gjendje të ndërtojë një forcë gjatë periudhës afatmesme dhe afatgjatë, që të sigurojë të ardhura më të larta nga taksat, ndërkohë që forcohet lidhja qeveri-biznes. Në të njëjtën kohë, firmat do të përfitojnë nga konkurrenca më e ndershme, shërbime publike të përmirësuar dhe, mundësisht, taksa më të ulëta në periudhë afatmesme, siç do të përfitojnë qytetarët shqiptarë nga realizimi i investimeve të SKZHES dhe përgjithësisht, me një qeveri më të gatshme dhe më të efektshme. Vetëm perspektiva për progres në procesin e integritit evropian duhet t'i japë qeverisë një shtytje tjetër shumë të rëndësishme për të mbështetur, me hapa konkretë, përpjekjet për rritjen e qeverisjes dhe për uljen e madhësisë së sektorit joformal. Publiku duhet të bindet me masa të prekshme se Shqipëria, ashtu si vendet e tjera në tranzicion para saj, është vërtet në rrugën e modernizimit, të prosperitetit dhe të ekonomisë evropiane. Parimisht, nuk ka asnjë arsye pse të mos jetë në gjendje ta bëjë këtë gjë.

Referencat

- Abed, George, and Sanjeev Gupta (eds.), 2002, *Governance, Corruption & Economic Performance* (Washington: International Monetary Fund).
- Alesina, Alberto, 1999, "Too Large and Too Small Governments," in Vito Tanzi, Ke-young Chu, and Sanjeev Gupta, ed., *Economic Policy & Equity* (Washington: International Monetary Fund).
- Altwater, Elmar, and Birgit Mahnkopf, 2002, *Globalisierung der Unsicherheit: Arbeit im Schatten, schmutziges Geld und informelle Politik* (Münster: Verlag Westfälisches Dampfboot).
- Asea, Patrick, 1996, "The Informal Sector: Baby or Bath Water?" *Carnegie-Rochester Conference Series on Public Policy*, Vol. 45, pp. 163–71.
- Bezemer, Dirk, 2001, "Post-Socialist Financial Fragility: the Case of Albania," *Cambridge Journal of Economics*, Vol. 25, pp. 1–23.
- Bhattacharyya, Dilip, 1993, *How Does the "Hidden Economy" Affect Consumers' Expenditure? An Econometric Study of the U.K. (1960 – 1984)*, (Berlin: International Institute of Public Finance).
- Blejer, Mario, Mauro Mecagni, Ratna Sahay, Richard Hides, Barry Johnston, Piroska Nagy, and Roy Pepper, 1992, "Albania: From Isolation Towards Reform," Occasional Paper No. 98 (Washington: International Monetary Fund).
- Cassel, Dieter, 1986, "Funktionen der Schattenwirtschaft im Koordinationsmechanismus von Markt- und Planwirtschaft," in *Ordo—Jahrbuch für die Ordnung von Wirtschaft und Gesellschaft*, Vol. 37, pp. 73–103.
- Cooper, Russell, and Andrew John, 1991, "Coordinating Coordination Failures," in Gregory Mankiw and David Romer, *New Keynesian Economics*, Vol. 2 (Cambridge: MIT Press), pp. 3–24.
- de Soto, Hernando, 1989, *The Other Path* (New York: Harper and Row).
- European Bank for Reconstruction and Development, 2002, *Transition Report 2002: Agriculture and Rural Transition* (London: European Bank for Reconstruction and Development).
- European Union, 2002a, "2458th Council Meeting, Luxembourg, 21 October 2002," General Affairs and External Relations Document No. 12943/02 (Presse 314).
- , 2002b, "Albania: Stabilisation and Association Report," Commission Staff Working Paper No. COM (2002)-163.
- Feige, Edgar (ed.), 1989, *The Underground Economies. Tax Evasion and Information Distortion* (Cambridge: Cambridge University Press).

- , 1986, “A Re-Examination of the ‘Underground Economy’ in the United States. A Comment on Tanzi,” *IMF Staff Papers*, Vol. 33, No. 4, pp. 768–81.
- Friedman, Eric, Simon Johnson, Daniel Kaufman, and Pablo Zoido-Lobaton, 2000, “Dodging the Grabbing Hand: The Determinants of Unofficial Activity in 69 Countries,” *Journal of Public Economics*, Vol. 76 (June), pp. 459–93.
- Government of Albania, 2003, *Progress Report for Implementation 2002 Objectives and Long Term Vision of the NSSD Priority Action Plan 2003* (Tirana: Republic of Albania, Council of Ministers).
- , 2001, *National Strategy for Socio-Economic Development*, November 2001 (Tirana: Republic of Albania, Council of Ministers).
- Gretschmann, Klaus, 1984, “Wohlfahrtseffekte schattenwirtschaftlicher Aktivitäten?” in Klaus Gretschmann, Rolf Heinze, and Bernd Mettelsiefen (eds.), *Schattenwirtschaft. Wirtschafts- und sozialwissenschaftliche Aspekte, internationale Erfahrungen* (Göttingen: Vandenhoeck und Ruprecht), pp. 97–129.
- Gupta, Sanjeev, Hamid Davoodi, and Rosa Alonso-Terme, 1998, “Does Corruption Affect Income Inequality and Poverty?” IMF Working Paper No. 98/76.
- Hofreither, Markus, and Friedrich Schneider, 1989, “Gibt es ein politisches Interesse, die Schattenwirtschaft zu bekämpfen? Ein Versuch politisch-ökonomischer Erklärung,” in E. Boetcher, P. Herder-Dornreich, K.E. Schenk (eds.), *Jahrbuch für Neue Politische Ökonomie* (Tübingen: J.C.B. Mohr–Paul Siebeck), pp. 62–87.
- International Monetary Fund, 2003a, “Albania: Second Review Under the Three-Year Arrangement Under the Poverty Reduction and Growth Facility—Staff Report; Staff Statement; Press Release on the Executive Board Discussion; and Statement by the Executive Director for Albania,” IMF Country Report No. 03/218.
- , 2003b, “Albania: Joint Staff Assessment of the Poverty Reduction Strategy Paper Annual Progress Report,” IMF Country Report No. 03/219.
- , 2002, “Albania: Request for a Three-Year Arrangement Under the Poverty Reduction and Growth Facility—Staff Report; News Brief and Press Release on the Executive Board Discussion; and Statement by the Executive Director for Albania,” IMF Country Report No. 02/135.
- , 2001a, “Albania: 2001 Article IV Consultation and Review Under the Poverty Reduction and Growth Facility—Staff Report and Public Information Notice on the Executive Board Discussion,” IMF Country Report No. 01/117.
- , 2001b, *International Financial Statistics: Yearbook 2001* (Washington: International Monetary Fund).

- , 2000, *World Economic Outlook, May 2000* (Washington: International Monetary Fund).
- Jarvis, Chris, 2000, "The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania," *IMF Staff Papers*, Vol. 47, No. 1, pp. 1–29.
- Johnson, Simon, Daniel Kaufmann, and Andrei Shleifer, 1997, "The Unofficial Economy in Transition," *Brookings Papers on Economic Activity*, No. 2, pp. 159–221.
- Loayza, Norman, 1997, "The Economics of the Informal Sector: A Simple Model and Some Empirical Evidence from Latin America," Policy Research Working Paper 1727 (Washington: The World Bank).
- Lackó, Mária, 2000, "Hidden Economy—An Unknown Quantity? Comparative Analysis of Hidden Economies in Transition Countries, 1989–95," *Economics of Transition*, Vol. 8, No. 1, pp. 117–49.
- Mauro, Paulo, 1995, "Corruption and Growth," *Quarterly Journal of Economics*, Vol. 110 (August), pp. 681–712.
- Naylor, Robin, 2002, *Wages of Crime—Black Markets, Illegal Finance, and the Underworld Economy* (Ithaca: Cornell University Press).
- Prodi, Romano, 2003a, Speech given at the ceremony on the opening of the negotiation of a Stabilization and Association Agreement between the EU and Albania, Tirana, January 31, 2003..
- , 2003b, "Albania's European Destiny," Speech to the Albanian Parliament, January 31, 2003.
- Schneider, Friedrich, 2002, "The Value Added of Underground Activities: Size and Measurement of the Shadow Economies of 110 Countries all over the World," Johannes Kepler Universität Linz, Mimeo. (First version, June 2002).
- , 1998, "Die im Dunkeln sieht man nicht. Schwarzarbeit als wirtschafts- und staatspolitische Herausforderung," *Handelsblatt*, Nr. 40, February 26, 1998.
- and Dominik Enste, 2000a, *Schattenwirtschaft und Schwarzarbeit: Umfang, Ursachen, Wirkungen und wirtschaftspolitische Empfehlungen* (Munich: Oldenbourg Verlag).
- and ———, 2000b, "Shadow Economies Around the World: Size, Causes, and Consequences," IMF Working Paper No. 00/26.
- Schrage, Horst, 1984, "Schattenwirtschaft—Abgrenzung, Definition, Methoden der quantitativen Erfassung," in Wolf Schäfer (ed), *Schattenökonomie. Theoretische Grundlagen und wirtschaftspolitische Konsequenzen* (Göttingen: Vandenhoeck und Ruprecht), pp. 11–37.

- Schumpeter, Joseph, 1942, *Capitalism, Socialism and Democracy* (New York: Harper Torchbooks, 3rd edition 1950).
- Shleifer, Andrei, and Robert Vestny, 1993, "Corruption," *Quarterly Journal of Economics*, Vol. 108, No. 4, pp. 559–617.
- Tanzi, Vito, 1998, "Corruption Around the World," *IMF Staff Papers*, Vol. 45, No. 4, pp. 559–94.
- , 1986, "The Underground Economy in the United States. Reply to Comments by Feige, Thomas and Zilberfarb," *IMF Staff Papers*, Vol. 33, No. 4, pp. 799–811.
- , 1983, "The Underground Economy in the United States. Annual Estimates 1930–1980," *IMF Staff Papers*, Vol. 30, No. 2, pp. 283–305.
- , and Hamid Davoodi, 2000, "Corruption, Growth, and Public Finances," IMF Working Paper No. 00/182.
- , and ———, 1997, "Corruption, Public Investment, and Growth," IMF Working Paper No. 97/139.
- , and George Tsibouris, 2000, "Fiscal Reform Over Ten Years of Transition," IMF Working Paper No. 00/113.
- Thomas, Jim, 1992, *Informal economic activity* (New York: Harvester/Weatsheaf).